



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, duke u bazuar në nenin 2 të Shtojcës së Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.10/25 të datës 20.05.2025 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës-IADK, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

1. Me këtë Vendim i **TRANSFEROHET** shuma e mjeteve në vlerë prej 500 € (pesëqind euro), Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës-IADK, për të vepruar, konform nenit 2 të Shtojcës së Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.10/25 të datës 20.05.2025 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës-IADK, qëllimi i së cilës është përfshirja e një përfituesi/pjesëmarrësi shtesë në skemën e mbështetjes me grant në kuadër të projektit "Fuqizimi i grave, burrave dhe të rinjëve që jetojnë në zonat rurale me sfida ekonomike, të krijojnë mjete jetese të qëndrueshme nëpërmjet aktiviteteve bujqësore dhe përpunimit të ushqimit" financuar nga FRIEDA.

Neni 2

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës -IADK do të raportoj me shkrim Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari, lidhur me veprimet e ndërmarra, konform dispozitave të Shtojcës së Marrëveshjes ku përfshihet Raporti financiar lidhur me mjetet e shpenzuara dhe arsyetimi i tyre me fatura dhe dokumentacion tjetër përkatës.

Neni 3

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit, kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për vitin 2026 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari në xhironlogarinë bankare nr 2027-000021-7128-84 në TEB Bankë në emër të IADK-së.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

1Nr. 01-400/01-22490
Lipjan, më 19.06.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 të Ligjit Nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, nenit 4 të Udhëzimit administrativ nr.01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektin e sektorit publik si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR THEMELIMIN E KOMITETIT TË AUDITIMIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Themelimi ,përbërja dhe mandati i Komitetit të Auditimit

Me këtë Vendim, themelohet Komiteti i Auditimit në Komunën e Lipjanit (në vazhdim të tekstit Komiteti), në përbërje si vijon:

1. Fitim Sadiku, nga shoqëria civile, Kryesues,
2. Fatbardha Shurdhiqi, nëpunëse civile, anëtare,
3. Shkëlqim Bahtiri nga shoqëria civile, anëtar

Mandati i Komitetit është 3 (tre) vjeçar.

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe takimet e Komitetit

1. Komiteti do ti kryej detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me dispozitat të Ligjit Nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike dhe Udhëzimit administrativ nr.01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektin e sektorit publik.
2. Takimet e Komitetit të Auditimit mbahen së paku katër (4) herë në vit dhe ftohen nga Kryesuesi i Komitetit të Auditimit
3. Udhëheqësi i njësise së auditimit të brendshëm merr pjesë në takimet e Komitetit të Auditimit me përjashtim kur Komiteti i Auditimit diskuton temat që ndërlidhen me performancën e Njësise së auditimit të brendshëm të subjektit të sektorit publik.
- 4.Njësia e auditimit të brendshëm ofron shërbimet e sekretarisë për Komitetin e Auditimit
- 5.Pagesa e anëtarëve të Komitetit bëhet në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohen Njësia e Auditimit të brendshëm, Kryesuesi dhe anëtarët e Komitetit .

1Nr. 020/04-26877
Lipjan, më 16.06.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores MF- Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 si dhe Rekomandimit të Komisionit për vlerësim e pasurisë jofinanciare të komunës 01-404/01-28096 të datës 23.06.2026, Kryetari i Komunes, nxjerr

V E N D I M

PËR TRANSFERIMIN – DHURIMIN E ASETEVE KOMUNALE -INVENTARIT JASHTË PËRDORIMIT

I. I transferohen – dhurohen, OJQ-së “Vizioni Rinor i Shalës” asetet komunale- inventari jashtë përdorimit , në pronësi të komunës sipas Rekomandimit të Komisionit për vlerësim e pasurisë jofinanciare të komunës 01-404/01-28096 të datës 23.06.2026, me shënimet si vijon:

Nr	Emërtimi i aseteve	Sasia	Barkodi
1	Vitrinë druri 28564	1	KLyKKL1-788
2	Orman me dy dyer 168027	1	KLyKKL1-12178
3	Vitrinë druri 28564	1	KLyKKL1-740
4	Orman me nr. Serik 0010837	1	Pa barkod
5	Orman me nr. Serik 001417	1	Pa barkod

II. Vendimi hyn në fuqi menjëherë

ARSYETIM

Transferimi - dhurimi i aseteve të lartëcekura të cilat janë jashtë funksionit bëhet në pajtim me dispozitat e nenit 9 – Tjetërsimi i pasurisë financiare të Rregullores MF- Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore dhe Rekomandimit të Komisionit për vlerësim e pasurisë jofinanciare të komunës të datës 23.06.2026 për arsye se të njëjtat janë të nevojshme për OJQ- në “Vizioni Rinor i Shalës” të cilët paraprakisht i kanë parashtruar kërkesë Drejtoratit për Administratë .

Vendimi i dërgohet:

OJQ- së “Vizioni Rinor i Shalës”

Drejtoratit për Administratë

Zyrtarit për Pasuri

1Nr. 404/01-2809/2

Lipjan, më 26.06.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores MF – NR.02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke u bazuar në Rekomandimin e Komisionit për përcaktimin e çmimit fillestar për shitjen e prodhimeve bimore të grurit të datës 03.06.2026, Kryetari i Komunes, nxjerr

**VENDIM
PËR SHITJEN E PRODHIMEVE BIMORE TË GRURIT**

Neni 1

Me këtë Vendim në procedurë të ankandit publik sipas Rekomandimit të Komisionit për përcaktimin e çmimit fillestar për shitjen e prodhimeve bimore të grurit të datës 03.06.2026, do të bëhet shitja e prodhimeve të grurit me çmim fillestar prej 0.17 cent për kg, në sipërfaqet që janë në shfrytëzim nga SHMP “ Adem Gllavica ” – Lipjan, Ekonomia bujqësore.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Arsim dhe Drejtorati për Prokurim.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Arsim.

1Nr. 320/01-25555
Lipjan, më 05.06.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke u bazuar në Vendimin Nr. 05-453/01-27509 të datës 19.06.2026 të Komisionit vlerësues për shpalljen e listës përfundimtare për OJQ-në përfituese për Thirrjen publike "Mërgata Fest and Sports 2026" me Nr. 05-453/01-18462 të datës 22.04.2026, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR OJQ-në PËRFITUESE
QËLLIMI PËR TROFE

Neni 1

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 30.000.00 (tridhjetë mijë euro) për subvencionimin e OJQ-së përfituese **QËLLIMI PËR TROFE – GOAL FOR THE TROPHY** e cila ka aplikuar sipas Thirrjes publike "Mërgata Fest and Sports 2026" me Nr. 05-453/01-18462 të datës 22.04.2026, të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

2. Në tabelën vijuese është OJQ-ja e cila është shpallur përfituese .

Nr.	Emërtimi i OJQ-së	Shuma
1.	QËLLIMI PËR TROFE- GOAL FOR THE TROPHY	30.000.00 €
	Shuma Totale	30,000.00 €

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2026 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 3

1. Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe OJQ-së do të rregullohen në kontratë e cila do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe OJQ-së përfituese .

2.Kontratat do të lidhen vetëm me ato OJQ të cilat para nënshkrimit të Kontratës kanë paraqitur Prova se menaxheri i projektit nuk është nën hetime për vepra penale si dhe prova se OJQ ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara ashtu siq precizohet edhe në Thirrjen e cekur publike.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 453/01-27509/2
Lipjan, më 22.06.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **8,960.00€**, (tetëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/04-24352 e datës 01.06.2026, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 32 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin maj të vitit 2026 me nga 280 euro për secilin rast $32 \times 280 = 8,960.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/04-24352
Lipjan, më 02.06.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 10 të Rregullorës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës 15Nr.463-4312 të datë 19.01.2021 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT**

**Neni 1
Përbërja**

Formohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrohen nga personat fizik dhe juridik për marrjen, shfrytëzimin dhe vendosjen e objekteve të ndryshme në hapësirat publike në fushën e kompetencës nga Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, në këtë përbërje:

1. Rafete Retkoceri, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Kryesuese
2. Enver Elshani, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar
3. Salihe Marevci, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtare

**Neni 2
Detyrat përgjegjësitë dhe mandati**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit janë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrohen nga personat fizik dhe juridik, për shfrytëzimin e hapësirave publike që janë në kompetencë të Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim. Komisioni do të bëjë shqyrtimin e këtyre kërkesave në bazë të kriterëve të Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës 15Nr.463-4312 të datë 19.01.2021 si dhe Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike të Komunës së Lipjanit si dhe dispozitave tjera përkatëse në fuqi dhe pas shqyrtimit i rekomandon Drejtorit të Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim aprovimin apo refuzimin e kërkesës.
2. Mandati i komisionit është dy (2) vite.

**Neni 3
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Kryesuesja dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/01-28614
Lipjan, më 25.06.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve –, që kanë aplikuar sipas thirrjes publike "Rinia Fest –Lipjan 2026" në Komunen e Lipjanit" Nr.05-453/01-20346 të datës 04.05.2026, në përbërje si vijon:

1. Ramiz Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Trimor Shamolli, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Albulena Salihu, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Violeta Hetemi nga OJQ-të anëtare
5. Erdona Kadriolli, në cilësinë e ekspertës të jashtme, anëtare
6. Albulena Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtarë rezervë

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që kanë aplikuar sipas thirrjes publike "Rinia Fest-Lipjan 2026 në Komunen e Lipjanit" Nr.05-453/01-20346 të datës 04.05.2026, të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport. Komisioni do t'i kryejë detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 02.06.1-27598
Lipjan, më 19.06.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr.03/L-2012 të Punës, nenit 25 të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR.01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës nxjerr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të stafit shëndetësor për procesin e konkursit publik të shpallur nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale QKMF – Dr. Mehdi Zejnullahu – Lipjan Nr.03.111/01-9674 i datës 24.02.2026, në këtë përbërje:

1. Halil Vehapi, QKMF-Lipjan, Kryesues,
2. Valdete Muji, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtare dhe
3. Rizvan Hoxha, Sektori për personel, anëtare

Neni 2
Detyrat e punës

1. Detyrë e Komisionit të ankesave është shqyrtimi i ankesave për procesin e konkursit publik të shpallur nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale QKMF – Dr. Mehdi Zejnullahu – Lipjan Nr.03.111/01-9674 i datës 24.02.2026 si dhe ka mandat të përkohshëm përkatësisht vlen vetëm për procedurat e konkurseve të cekur.
2. Komisioni shqyrton ankesën dhe publikon rrezultatit përfundimtar brenda 5 (pesë) ditëve dhe për secilën ankesë nxjerr vendim në pajtim me dispozitat e Udhëzimit Administrativ MFPT-NR.01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik si dhe Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative.

Neni 3
Hyrja në fuqi

1. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-26091
Lipjan, më 09.06.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, nenit 23 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATËS

Neni 1

Me këtë Vendim, **Ramiz Gashi**, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** Zyrar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës së OJQ-së përfituese të subvencioneve OJQ-në „**QËLLIMI PËR TROFE – GOAL FOR THE TROPHY**„ për Thirrjen publike Nr.5-453/01-18462 të datës 22.04.2026 “ **Mërgata Fest and Sports 2026**”, të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 2

Zyrtari përgjegjës është e obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontratës së OJQ-së përfituese të subvencioneve, OJQ-në “**QËLLIMI PËR TROFE – GOAL FOR THE TROPHY**” konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtari përgjegjës **Ramiz Gashi** dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

1Nr. 01-112/02-28674
Lipjan, më 26.06.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

